

Data 24.12.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Automatizimi i proceseve kritike të rikuperimit dhe kontrollit të aksesit në sistemet operacionale të OSHEE Group sh.a”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT- 42961100-1 -
Sisteme kontroll aksesi.

VLERA E FONDIT LIMIT: 150,000,653 (Njëqind e pesëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre)lekë, pa TVSH, ose **1,550,554.6 (një milion e peseqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e kater pikë gjashte)** euro pa TVSH. *Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 24.12.2025, 1 euro = 96.74 All.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

Ne zbatim te Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit kemi te bejme me nje sistem qendror i cili bazohet dhe karakterizohet nga nderlidhja e pashmangshme e disa zgjidhjeve teknologjike, duke bere te mundur vetem Upgrade, zgjerim dhe permiresim te sistemit aktual. Ndarja ne lote do ta bente te pa ekezekutueshme kontraten pasi eshte nje sistem kompleks dhe i perqendruar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rendesinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nenin 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate faktin qe te krijohen kushtet per nje konkurrence te hapur dhe per te mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik qe ofrojnë këto lloj shërbimesh, pavaresisht rendesise dhe kompleksitetit te shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe ne frymen e konkurueshmerise qe gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlere e kërkuar qe OE ofertues te ketë bërë/realizuar me kontrata te ngjashme, te jetë rreth 35 % e vlerës (ne vijimesi edhe me LLP te meparshem) dhe ne këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë qe OE ofertues do jete realisht ne gjendje te realizoje kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurinë e punës se AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare:

- 1) **ISO 9001** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- 2) **ISO 27001** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);
- 3) **ISO/IEC 20000-1** ose ekuivalente, per menaxhimin e shërbimeve te teknologjise se informacionit (e vlefshme);

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme jane percaktuar bazuar ne nenin 79, te ligjit nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenin 44 te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe si kompani kane kualifikimet / certifikimet e duhura organizative dhe operacionale te nevojshme per te zbatuar kontraten.

Konkretisht:

Kerkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001 ose ekuivalent, sherben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale ne menyre

cilesore dhe te plote, bazuar ne organizimin e brendshem per menaxhimin sa me te mire te cilesise implementuese. Ky certifikim kerkohet ne perputhje me proporcionalitetin e vleres se fondit limit te vendosur ne dispozicion dhe bazuar ne kompleksitetin dhe rendesine e funksionalitetit online te sistemeve aktuale qe OSHEE Group SHA ka ne perdorim.

Perkatesisht kjo lloj ISO specifikon kerkesat per nje sistem cilesor te menaxhimit te cilesise, kur nje organizate:

- Duhet te deshmoje kapacitetin per te siguruar vazhdimisht produktin qe kenaq klientin dhe kerkesat statutore dhe normative te aplikueshme.
- Synon te permiresoje kenaqjen e klientit, nepermjet aplikimit te sistemit, duke perfshire proceset per permiresimin e vazhdueshem te sistemit dhe garancise te konformitetit me klientin dhe kerkesat statutore dhe normative te aplikueshme.

Kerkesa Lidhur me certifikimin ISO 27001 ose ekuivalent sherben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale duke siguruar qe informacionet (siç jane ato qe permbajne sistemet ekzistuese te AK dhe e kane nje rendesi dhe konfidencialitet te larte) te menaxhohen ne menyre te sigurte nga pikepamja informatike dhe te jene te kontrolluara si dhe aksesimi mbi to te jete i verifikueshem e i kodifikuar. Kjo vjen pasi ne kete kontrate do te kete edhe perdorim te aplikacioneve te reja per diagnostikimin e elementeve te sigurise se sistemeve ekzistuese qe kerkojne kompetence te shtuar profesionale ne kete drejtim. Ky certifikim kerkohet ne perputhje me proporcionalitetin e vleres se fondit limit te vendosur ne dispozicion dhe bazuar ne kompleksitetin dhe rendesine e funksionalitetit online te sistemeve aktuale qe OSHEE Group SHA ka ne perdorim.

Kerkesa Lidhur me certifikimin ISO 20001-1 ose ekuivalent sherben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale duke qene se zoteron nje sistem menaxhimi per sherbimet e teknologjise se informacionit, duke pasur me shume garanci qe ky i fundit te planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirembajë dhe permiresojë te gjithë sistemin ne teresi, i cili eshte teresisht i bazuar ne produkte TIK (software dhe hardware). Ky certifikim kerkohet ne perputhje me proporcionalitetin e vleres se fondit limit te vendosur ne dispozicion dhe bazuar ne kompleksitetin dhe rendesine e funksionalitetit online te sistemeve aktuale qe OSHEE Group SHA ka ne perdorim.

2. Për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE/BOE dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, për shitjen dhe shërbimin për zerat nga 1.1 deri tek zeri 3.10 objekt i këtij prokurimi. Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit të autorizuar të përfshijë të dhëna të plota me objekt dhe numer reference të procedurës dhe detaje për kontaktin. Në rast të paraqitjes së Autorizimeve të

kërkuara nga Distributori i Autorizuar respektiv te vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit te autorizuar.

Argumentim: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë edhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së shërbimeve. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit te cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për Autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet shërbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses te kontratës, duhet te kete te punesuar për të paktën muajin e fundit (*nga data e publikimit te njoftimit te kontrates*) dhe të disponojë si staf te tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- a) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar ITIL për menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente.
- b) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar per menaxhim projektesh.
- c) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar System Administrator Linux/Windows ose ekuivalente
- d) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar Security Operations ose ekuivalente
- e) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar Cybersecurity Analyst ose ekuivalente
- f) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar Identity & Access Management ose ekuivalente
- g) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar Penetration Testing ose ekuivalente
- h) Të paktën 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi per te instaluar dhe implementuar zgjidhjen e ofertuar per Storage scale-out.

- i) Te paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional “CCNP Security” ose ekuivalent nga prodhuesi per te instaluar dhe implementuar zgjidhjen e ofertuar per SD-WAN upgrade.
- j) Të paktën 2 (dy) specialist te certifikuar ne nivel profesional “CCNP për rrjetin” ose ekuivalent nga prodhuesi per te instaluar dhe implementuar zgjidhjen e ofertuar per Upgrade i Ruterave te dispecerise me LTE per zyrat e Dispecerive.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per periudhen e dates se hapjes se tenderit.

Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:

- *Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm.*
- *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vertetues, per muajin e fundit;*

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatorët ekonomike te deshmojne qe kane personelin minimal te nevojshem per realizimin me sukses te kontrates.

Argumentimi Teknik: Per kriterin ne piken a) duke qene se objekti i prokurimit jane produkte dhe procese IT, ruajtjen e te dhenave qe gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te ***paktën 1 (nje) specialist te certifikuar ITIL për menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente*** për te vene ne zbatim ekspertizen e tij profesionale per te gjitha llojet e te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne qe te zbatohet legjislacioni vendas dhe ai i BE-se (per

rregulloren GDPR etj te ngjashme) per ruajtjen sa me te plote te konfidencialitetit te te dhenave qe mund te jene te stafit te kompanise/AK-se apo te klienteve e furnitoreve te shumte qe kane keto sisteme ne teresi. Ky certifikim eshte vendosur ne perputhje me madhesine e vleres se fondit limit te vene ne dispozicion, ne proporcion ndaj te gjithe profileve te eksperteve te sigurise kibernetike dhe menaxheriale te kerkuar ne kete prokurim dhe bazuar ne kompleksitetin e zbatimit te rregulloreve per rendesine e madhe qe ka konfidencialiteti i te dhenave digjitale ne kuptim te legjislacionit aktual shqiptar dhe me gjere atij te BE-se;

Per kriterin ne piken b) gjykohet se eshte i domosdoshem ne kushtet e madhesise dhe kompleksitetit te realizimit te kontrates dhe rendesise operationale qe kane sistemet te AK, ku te gjitha keto duhet domosdoshmerisht te ndiqen nga nje profesionist i kualifikuar PMP ose ekuivalent ne menaxhimin e projekteve nga fillimi (nenshkrimi i kontrates) deri ne perfundim te saj, ne menyre qe te minimizohet ne maksimum risku i mosrealizimit te kontrates per arsye menaxheriale. Ky lloj certifikimi eshte standard i kerkuar gjeresisht, dhe garanton Autoritetin Kontraktor se OE ka kapacitetet menaxheriale, njohuri dhe ekspertize te thelluar ne menaxhimin e projekteve, kredibilitet profesional si dhe sherben si nje pike referuese nga ana e AK gjate zbatimit te kontrates.

Per kriterin ne piken c) duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave qe gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar System Administrator Linux/Windows ose ekuivalente” për të vënë ne zbatim ekspertizen e tij profesionale analizuese, analitike, raportuese, trainuese, për të qenë në pararojë të mbrojtjes nga sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese te te gjitha llojeve te te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne qe kjo e fundit, nepermjet stafit te saj TIK, pasi te trainohen me metodikat dhe udhezimet specifike te ketij profil profesionisti, te maksimizoje efektshmerine e kunderpergjigjes duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e kunderpergjigjes ne rast suate gjendjeje nën sulm kibernetik.;

Per kriterin ne piken d) duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave qe gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar Security Operations ose ekuivalente” për të vënë ne zbatim ekspertizen e tij profesionale analizuese, analitike, raportuese, trainuese, për të qenë në pararojë të mbrojtjes nga sulmet/rreziqet

keqdashese/kompromentuese te te gjitha llojeve te te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne qe kjo e fundit, nepermjet stafit te saj TIK, pasi te trainohen me metodikat dhe udhezimet specifike te ketij profil profesionisti, te maksimizoje efektshmerine e kunderpergjigjes duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e kunderpergjigjes ne rast suate gjendjeje nen sulm kibernetik.;

Per kriterin ne piken e) duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave qe gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe kembehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar Cybersecurity Analyst ose ekuivalente” per te vene ne zbatim ekspertizen e tij profesionale analizuese, analitike, raportuese, trainuese, per te qene ne pararoje te mbrojtjes nga sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese te te gjitha llojeve te te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne qe kjo e fundit, nepermjet stafit te saj TIK, pasi te trainohen me metodikat dhe udhezimet specifike te ketij profil profesionisti, te maksimizoje efektshmerine e kunderpergjigjes duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e kunderpergjigjes ne rast suate gjendjeje nen sulm kibernetik.;

Per kriterin ne piken f) duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave qe gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe kembehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar Identity & Access Management ose ekuivalente” per te vene ne zbatim ekspertizen e tij profesionale analizuese, analitike, raportuese, trainuese, per te qene ne pararoje te mbrojtjes nga sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese te te gjitha llojeve te te dhenave digjitale qe qarkullojne/ruhen ne keto sisteme, duke garantuar AK-ne qe kjo e fundit, nepermjet stafit te saj TIK, pasi te trainohen me metodikat dhe udhezimet specifike te ketij profil profesionisti, te maksimizoje efektshmerine e kunderpergjigjes duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e kunderpergjigjes ne rast suate gjendjeje nen sulm kibernetik.;

Per kriterin ne piken g) duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim parainformimin/trainimin mbi rreziqet nga sulmet potenciale kibernetike nga jashte sistemeve dhe per ruajtjen e te dhenave qe gjenerohen, menaxhohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe kembehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar Penetration

Testing ose ekuivalente” për të vënë në zbatim ekspertizen e tij profesionale analizuese, analitike, raportuese, trainuese, për të qenë në pararojë të mbrojtjes nga sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese të të gjitha llojeve të të dhenave digjitale që qarkullojnë/ruhen në këto sisteme, duke garantuar AK-ne që kjo e fundit, nepermjet stafit të saj TIK, pasi të trainohen me metodikat dhe udhëzimet specifike të këtij profil profesionisti, të maksimizojë efektshmerinë e kunderpergjigjes duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e kunderpergjigjes në rast situatë gjendjeje nën sulm kibernetik.;

Për kriterin në pikën h) duke qenë se objekti i prokurimit është shitja dhe implementimi i paisjeve storage me qëllim parainformimin/trainimin për ruajtjen e të dhenave që gjenerohen, menaxhohen, transmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbëhen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese të Oshee Group sh.a me ato që do të vendosen të reja, është e nevojshme që OE të ketë një stafin e tij, të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për të instaluar dhe implementuar zgjidhjen e ofertuar për Storage scale-out” për të vënë në zbatim ekspertizen e tij profesionale analizuese, analitike, raportuese, trainuese, për të qenë në pararojë të mbrojtjes nga sulmet/rreziqet keqdashese/kompromentuese të të gjitha llojeve të të dhenave digjitale që qarkullojnë/ruhen në këto sisteme, duke garantuar AK-ne që kjo e fundit, nepermjet stafit të saj TIK, pasi të trainohen me metodikat dhe udhëzimet specifike të këtij profil profesionisti, të maksimizojë efektshmerinë e kunderpergjigjes duke implementuar/themeluar procedurat/rregulloret/politikat e kunderpergjigjes në rast situatë gjendjeje nën sulm kibernetik.;

Për kriterin në pikën i) duke qenë se objekti i prokurimit është Siguria me qëllim edhe menaxhimit të të dhenave që gjenerohen, transmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbëhen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese të Oshee Group sh.a, është e nevojshme që OE të ketë një stafin e tij, të paktën 2 (dy) specialiste të certifikuar në nivel profesional “CCNP Security” ose ekuivalent nga prodhuesi për të instaluar dhe implementuar zgjidhjen e ofertuar për SD-WAN upgrade për të instaluar dhe implementuar pajisjet e rrjetit të ofertuara, për këto lloje teknologjie e për të suportuar zgjidhjen e ofertuar “Routing and Switching”, duke garantuar AK për mos ndërprerje të shërbimit dhe vijimesinë e punës. Bejme sqarimin se certifikimet janë tepër të specializuara dhe të dedikuara, ndaj duhet të jenë të njëjta certifikimet e kërkuara nga AK. Kjo shërben për të tërhequr vëmendjen e operatorëve ekonomik që të jete tepër të specializuar në certifikimet që do paraqesin bashkë me ofertën. Specialistet kerkohen për të implementuar, suportuar si dhe për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese në, e cila është relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore

Per kriterin ne piken j) duke qene se objekti i prokurimit eshte Siguria me qellim edhe menaxhimin e te dhenave qe gjenerohen, trasmetohen, koordinohen/sinkronizohen dhe këmbehen nga infrastruktura dhe platformat teknologjike ekzistuese te Oshee Group sha, eshte e nevojshme qe OE te kete nje stafin e tij, të paktën 2 (dy) specialist te certifikuar ne nivel profesional “CCNP për rrjetin” ose ekuivalent nga prodhuesi per te instaluar dhe implementuar zgjidhjen e ofertuar per Upgrade i Ruterave, për kete lloj teknologjie e për të suportuar zgjidhjen e ofertuar per sigurinë e rrjetit “Security Routing and Switching”, duke garantuar AK per mosnderprerje te shërbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit